

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ, Departamenti i Pergjithshem- Divizioni Civil, me gjyqtarin Enes Mehmeti , ne ceshtjen e inicuar me padine e paditeses [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna Shtime, kunder te paditurit [REDACTED] [REDACTED] ne Ferizaj, per vërtetim pronësie, me date 10.10.2016, jashte seance ka marre kete:

A K T G J Y K I M
-pa shqyrtim kryesor te ceshtjes -

REFUZOHET si e pabazuar, padia dhe kërkesëpadia e paditesit [REDACTED] nga fshatin [REDACTED] Komuna Shtime, e ushtruar kundër të paditurës [REDACTED] [REDACTED] në Ferizaj, per vërtetimin e të drejtës së pronësisë në njësin kadastrale me numër 22, vendi i quajtur "Grkovo Kaljaja", zona kadastrale Petrovë ZK Shtime.

OBLIGOHET paditesi që të paguan taksën gjyqesore per padi dhe aktgjykim ne shume prej 75,00€, pas pranimit te ketij aktgjykimi, nen kercenimin e pasojave juridike.

A r s y e t i m i

Paditesi ka ushtruar padi kunder te paditures me datën 16.08.2016, me pretendimin se ka fituar të drejtën e pronësisë mbi këtë paluajtshmëri, pasi që është në posedim të pandërprerë prej vitit 1978 e tutje, dhe se në të njëjtën e ka blerë nga tani i ndjeri [REDACTED], si dhe ka theksuar në këtë paluajtshmëri ka të ndërtuara 4 shtëpi, shtalla, garazhë, dhe se asnjëherë nuk është penguar nga askush në ndërtimin e tyre, dhe se e paditura respektivisht ruajtësit e pyejeve këtë paluajtshmëri nuk e kontrollojnë.

Gjykata, pasi qe ka shqyrtuar shkresat e lendes, ka obliguar te paditurën qe te parashtron perjegjige ne padine të paditesit. E padituri ne pergjigjen e saj ne padi, ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditëses përkitazi me pretendimet e padisë për vërtetimin e të drejtës në pronësi mbi këtë pronë si dhe ka theksuar se pretendimet e paditësit se pronën e ka blerë nga [REDACTED] është i pabazuar, pasi që blerja nga jo pronari i saj nuk është bazë e fitimit të drejtës në pronësi, dhe se i njëjti nuk ka ofruar asnjë pronë për të vërtetuar faktin se prona objekt kontestit në emër të kujt ka qenë para vitit 1978. Po ashtu i njëjti ka theksuar se padia e paditësit është në kundërshtim me Ligjin për Pyjet e Kosovës nr.2003/3 përkatësisht ndryshimet Nr.03/L-153 të vitit 2010 ështëë paraparë "Pyjet dhe Tokat Pyjore publike janë në pronë të Shtetit të Kosovës" dhe se mbajtja në posedim arbitrar i saj nuk është bazë juridike e fitimit të së drejtës në pronësi.

Gjykata pas shqyrtimit te shresave te lendes dhe pretendimeve te cilat ka parashtruar i padituri ne pergjigje ne padi, nuk ka gjetur ndonje prove me te cilen mund te vazhdoje me shqyrtimin e kerkeses se paditesit, andaj ne baze te ketyre provave dhe fakteve ka gjetur se nuk ekzistojn pretendimet e paditesit që ka parashtruar ne padie dhe per pasoje e njejta ka rezultuar si e pathemelt.

Per shepnzimet e procedures, gjykata ka vendosur ne baze te UA nr.2008/2 te KGJK-se, per unifikimin e taksave gjyqesore.

Gjykata nga arsytet e lartcekura, ka vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi bazur ne nenin 152 te LPK-se.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ
C.nr.571/16, me datën 10.10.2016

Gjyqtari,
Enes Mehmeti

KËSHILLË JURIDIKE; Kunder ketij aktgjykimi eshte e lejuar ankesa ne afat prej 15 ditesh, pas pranimit te tij, ne gjykatën e Apelit ne Prishtinë, perms kesaj Gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KU

